



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 dhjetor 2021
Nr.ref.:RK 1920/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI163/21

Parashtrues

Arianit Sllamniku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të paspecifikuar të Kryetarit
të Komunës së Gjilanit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Arianit Sllamniku me vendbanim në Gjilan (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston një Vendim të paspecifikuar, të Kryetarit të Komunës së Gjiçanit, të cilin vendim nuk e ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të paspecifikuar të Kryetarit të Komunës së Gjiçanit, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës dhe në veçanti bashkëshortes së tij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 26 [E Drejta e Integritetit Personal]; 35 [Liria e Lëvizjes]; 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve]; 53 [Interpretim i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale], të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë.
6. Më 15 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Cakanimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci.
7. Më 22 shtator 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoj që të dorëzojë dokumentet dhe informatat si në vijim:
 - (i) që të specifikoni numrin dhe datën e Vendimit të cilin e kontestoni në kërkesën tuaj, duke e bashkëngjitur edhe një kopje të këtij Vendimi;
 - (ii) të dorëzoni në Gjykatë dëshmitë përkatëse që tregojnë/apo dëshmojnë se si jeni i afektuar nga Vendimi të cilin e kontestoni, gjegjësisht të dorëzoni një kopje të kartelës apo dëshmisë tjetër përkatëse që tregon se jeni i punësuar në institucionet publike/komunale; dhe
 - (iii) të elaboroni se si nenet e Kushtetutës, të përmendura në kërkesën e juaj janë shkelur përmes Vendimit të cilin e kontestoni.
8. Më 1 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës nuk dorëzoi kopjen e Vendimit të paspecifikuar të Kryetarit të Komunës; nuk dorëzoi ndonjë dëshmi se si është i afektuar nga vendimi i paspecifikuar, të cilin ai e konteston para Gjykatës dhe dorëzoi vetëm kopjen e lejes së njoftimit të bashkëshortes së tij.

9. Më 25 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij ka dorëzuar kopje të medieve elektronike dhe atyre sociale. Sipas një njoftimi të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës, i publikuar në rrjetin social *Facebook* komunikohet që Kryetari i Komunës së Gjilanit më 6 shtator 2021 ka nxjerrë vendim, i cili sipas këtij komunikimi *“punëtorët e shtetit përfshirë shërbyesit civilë, zyrtarët publikë, mjekët, infermierët, mësimdhënësit, zjarrfikësit, punëtorët teknike etj. nuk do të mund të futen në vendet e tyre të punës pa konfirmim të vaksinimit test PCR apo test rapid antigjen.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Parashtruesi i kërkesës në informatën e tij të plotësuar, të 1 tetorit ka specifikuar se ai nuk është i punësuar, megjithatë Vendimi i paspecifikuar i Kryetarit të Komunës në mënyrë të drejtpërdrejtë kufizon bashkëshorten e tij, e cila është e punësuar si mësimdhënëse në këtë komunë dhe nuk ka drejtë të hyjë në vendin e saj të punës pa dëshmi të vaksinimit kundër COVID-19, testit PCR apo testit rapid antigjen.
12. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij, të parashtruar më 10 shtator 2021 specifikon se: *“Jemi te bindur se ky vendim është shkelje flagrante dhe e paprecedent e shkeljes themelore të të drejtave të njeriut dhe si e tillë e rrezikon mirëqenien elementare dhe ekzistenciale të mbi 90.000 banorëve të komunës së Gjilanit por jo vetëm të kësaj komune dhe si e tillë kërkojmë që të shqyrtohet me urgjence nga ana juaj.”* Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të paragrafëve 2, 3 dhe 4 të nenit 26 [E Drejta e Integritetit Personal]; të nenit 35 [Liria e Lëvizjes]; nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve]; nenit 53 [Interpretim i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.
13. Në vijim, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij të plotësuar, të dorëzuar më 1 tetor 2021 specifikon se atij dhe në veçanti bashkëshortes së tij mësimdhënëse i janë shkelur të drejta dhe liritë themelore të garantuar me dispozita të Kushtetutës.
14. Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, përkatësisht nëse ka përdorë ndonjë mjet juridik kundër Vendimit të paspecifikuar, të cilin ai e konteston, parashtruesi në kërkesën e tij theksoi se *“Për shkak të urgjencës dhe pasojave të cilat mund të ketë lënda në fjalë, kemi vendosur që drejtpërsëdrejti të ju paraqitemi juve i institucion supranacional për të dhënë mendim për çështjen në fjalë.”*
15. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *“të ndalohet çfarëdo kushtëzimi i personave të pavaksinuar me vaksinën kundër virusit Covid19 dhe mutacioneve tjera që burojnë nga ai si dhe detyrimi i vaksinimit përmes*

masave shtrënguese të cilat janë joligjore dhe nuk kanë mbështetje kushtetuese, ngase kushtetuta i garanton çdo qytetari të drejtën e zgjedhjes referuar nenit 26 të kushtetutës së republikës së Kosovës.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

18. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] dhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.”

[...]

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

19. Andaj, në vlerësimin nëse kërkesa e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e kërkesës së tij, Gjykata rikujton se neni 48 i Ligjit specifikisht detyron parashtruesit e kërkesave që të qartësojnë saktësisht aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë dhe që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë të jenë cenuar.

20. Në rastin konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në formularin e kërkesës ka theksuar, shprehimisht, se konteston një Vendim të paspecifikuar të

Kryetarit të Komunës së Gjilanit, të cilin nuk e ka dorëzuar në Gjykatë dhe për të cilin vendim i referohet njoftimit të Komunës së Gjilanit të publikuar në mediet elektronike dhe rrjetin social *Facebook*.

21. Në kërkesën e tij, të dorëzuar më 10 shtator 2021, parashtruesi nuk kishte specifikuar Vendimin të cilin e konteston dhe as nuk kishte dorëzuar një kopje të këtij vendimi, por kishte dorëzuar kopje të artikujve të medieeve elektronike në lidhje me njoftimin për nxjerrjen e këtij vendimi të paspecifikuar; dhe (ii) nuk kishte dorëzuar ndonjë dëshmi, përmes të cilës dëshmohet se si ky vendim i paspecifikuar dhe i kontestuar nga ai afekton të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë.
22. Gjykata sqaron se në raste të kërkesave të pakompletuara dhe të pa plotësuara, Ligji dhe Rregullorja e punës përcaktojnë procedurën që duhet ndjekur nga Gjykata në mënyrë që parashtrueseve t'u jepet mundësi për të kompletuar dhe plotësuar kërkesat e tyre. Në kontekst të kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] (2) (h), të Rregullores së punës.
23. Në lidhje me këtë, Gjykata sjellë në vëmendje se më 22 shtator 2021 e njoftoi parashtruesin e kërkesës në lidhje me kërkesën e tij dhe të njëjtit i kërkoi: (i) që të specifikojë numrin dhe datën e Vendimit të cilin e konteston në kërkesën e tij, duke e bashkëngjitur edhe një kopje të këtij Vendimi; (ii) të dorëzojë në Gjykatë dëshmitë përkatëse që tregojnë/apo dëshmojnë se si ai është i afektuar nga Vendimi të cilin e konteston, gjegjësisht të dorëzojë një kopje të kartelës apo dëshmisë tjetër përkatëse që tregon se është i punësuar në institucionet publike/komunale; dhe (iii) të elaborojë se si nenet e Kushtetutës, të përmendura në kërkesën e tij janë shkelur përmes Vendimit të cilin e konteston.
24. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se përkundër kërkesës specifike të Gjykatës, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e plotësuar nga ai, dhe të dorëzuar më 1 tetor 2021: (i) sërish nuk specifikoi numrin dhe datën e Vendimit të cilin e konteston në kërkesën e tij, dhe nuk dorëzoi një kopje të këtij Vendimi; (ii) nuk dorëzoi dëshminë përkatëse që tregon se është i punësuar në institucionet publike/komunale, por njoftoi Gjykatën se ai personalisht nuk është i punësuar por është bashkëshortja e tij, e cila si mësimdhënëse e punësuar në këtë komunë nuk mund të hyjë në vendin e saj të punës pa dëshmi të vaksinimit kundër COVID-19, testit PCR apo testit rapid antigjen.
25. Prandaj, Gjykata thekson se përkundër kërkesës së saj për dorëzimin e informatave specifike, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar dokumentet dhe informatat e kërkuara përkatëse e që në mënyrë specifike ndërlidhen me kërkesën e nenit 48 të Ligjit, për saktësimin dhe dorëzimin e vendimit të kontestuar nga ai.
26. Prandaj bazuar në atë si më lartë, Gjykata i referohet paragrafit 5 të rregullit 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim: "*Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë*

përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën, [...].”

27. Në raste të tilla, Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i refuzon këto kërkesa me procedure të shkurtër (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI 60/20, me parashtrues *Këshilli i Bashkësisë së Fesë Islame*, Vendim për refuzim i 18 shkurtit 2021, paragrafi 36; KI90/20, me parashtrues *Arben Boletini*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 25; dhe rastet nr. KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, me parashtrues *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 7 dhjetorit 2020, paragrafi 33 dhe referencat e përdorura aty).
28. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të mosaktësimit të vendimit të kontestuar dhe mosdorëzimit të tij në Gjykatë ashtu siç kërkohet me nenet 22 dhe 48 të Ligjit.
29. Rrjedhimisht, Gjykata, në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, përfundon se kërkesa duhet të refuzohet me procedure të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit, dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani